

Arkeologjia dhe trashëgimia kulturore, sinergji të reja mes UNIMC dhe UGJ

Arkeologjia dhe trashëgimia kulturore, sinergji të reja mes UNIMC dhe Universitetit të Gjirokastrës. Intensifikohet bashkëpunimi me Universitetin e Maceratës. [Unimc / Università degli Studi di Macerata](#) Diskutime mbi programet e studimit; tituj të përbashkët në histori dhe arkeologji; thellim i procesit të ndërkombëtarizimit të UGJ.

Pas vizitës njëjavore të delegacionit të Maceratës në Gjirokastrë, në kuadër të programit dypalësh Erasmus + ASPIC, një delegacion i Universitetit “Eqrem Çabej” vijoi vazhden e bisedimeve në Universitetin e Maceratës, Itali.

Gjatë takimeve u diskutuan mundësi të reja për zhvillimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve, duke filluar me titullin e dyfishtë (Diplomë Master i dyfishtë) që përfshin studentët e kursit të Historisë dhe Arkeologjisë për inovacion dhe pritet të nisë si program studimi vitin akademik 2022 – 2023.

Ndër të tjera gjatë takimeve u bisedua edhe mbi mundësinë e çeljes së një kursi të ri Bachelor me mbështetjen e UNIMC.

[Archeo Unimc - Gortina, Valle del Drino, Urbs Salvia](#)

[#arkeologji](#) [#history](#) [#kerkime](#) [#bashkepunim](#) [#albania](#) [#italia](#) [#macerata](#)



















